

## 17 tetor 2016

Në shtator 2016, Sekretariati organizoi takime me secilin prej anëtarëve të KI, përfaqësues të sektorit privat, mandati i të cilëve përfundoi në fund të qershorit 2016. Qëllimi i mbledhjeve ishte marrja e mendimeve mbi eksperiencën e tyre në KI, sugjerime për përmirësime në lidhje me KI dhe punën e Sekretariatit sikurse edhe në lidhje me klimën e investimeve në vend.



---

*Z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i Shoqatës së Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA) dhe CEO i Bankës Intesa SanPaolo në Shqipëri.*

---



---

*Z. Christian Canacaris, Kryetar i Shoqatës së Bankave në Shqipëri (ABA) dhe CEO i Bankës Raiffeisen në Shqipëri.*

---



---

*Z. Luan Muça, President i Delta Group.*

---



---

*Znj. Linda Legisi, Presidente e Omega shpk.*

---



---

*Z. Adamantios Frantzis, Drejtor i Përgjithshëm,  
TITAN - Antea Cement*

---



---

*Z. Nikolin Jaka, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë  
Tiranë*

---

## Mbi Eksperiencën si Anëtar i KI

*Si ka qenë eksperiencia juaj si anëtar i Këshillit të Investimeve?*

- ✚ Hap pozitiv për dialogun publik – privat në Shqipëri;
- ✚ Një platformë për dialog dhe ndjekje profesionale;
- ✚ Diskutime në mbledhje bazuar në çështje/raste reale dhe analiza teknike;
- ✚ Këshilli është struktura më e saktë për nga trajtimi i problematikave. Në cilësinë e Kryetarit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, si anëtar i Këshillit të Investimeve jam ndier mirë si në trajtimin dhe konsultimin paraprak ashtu dhe në shpalosjen e problematikave dhe shqetësimeve që Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë bëri në cilësinë e anëtarit të Këshillit.

## Formati i Këshillit

*Si ju duket formati dhe organizimi i mbledhjeve të Këshillit të Investimeve? A e vlerësoni KI si formatin e duhur të fokusuar në çështjet e klimës së investimeve, duke patur parasysh trekëndëshin e anëtarëve: institucione kombëtare; donatorë dhe institucione ndërkombëtare; biznese dhe shoqata biznesi?*

- ✚ Formati është i mirë dhe një platformë e projektuar mirë
- ✚ Mundësi transferimi pranë Zyrës së Kryeministrit
- ✚ Pjesëmarrja e Shoqatave të Investitorëve të Huaj nga vendet me kontributin më të lartë të tilla si Italia, Greqia, Austria.
- ✚ Formatu i mbledhjeve të Këshillit të Investimeve në procedurë krijon mungesën e vazhdueshmërisë së debatit dhe informacionit pasi procedura e rotacionit në një farë mënyre shkëput komunikimin e vazhdueshëm me anëtarin që largohet. Përsa i përket problematikave të ngritura dhe fokusit në gjykimin tim, duke u bazuar dhe në eksperiencën që unë pata, mendoj që Këshilli ishte në performancën e duhur.

## Metoda e Këshillit

*Cili është vlerësimi juaj mbi mënyrën/metodologjinë e trajtimit të tematikave në Këshillin e Investimeve.*

- ✚ Ofrimi i notave teknike dhe përfaqësimi i zërit të biznesit është mënyra e duhur;
- ✚ KI nevojitet të fokusohet më shumë në çështje dhe problematika specifike pasi kapacitetet janë të kufizuara;
- ✚ Gjenerojë debat mbi çështje të biznesit/investitorëve që kanë lidhje me klimën e investimeve;
- ✚ Qeveria të përdorë axhendën e KI për të diskutuar prioritetet, iniciativat dhe reformat e saj.
- ✚ Sekretariati i KI të mbetet teknik, i paanshëm dhe të përcjellë shqetësimet e biznesit pranë Qeverisë dhe anasjelltas (bottom-up approach);
- ✚ Lidhur me mënyrën dhe metodologjinë e trajtimit të problematikave jap vlerësimin maksimal për trajtimin në mënyrë objektive dhe profesionale të të gjitha tematikave dhe problematikave.

## Impakti i Këshillit

*A mendoni se puna e Këshillit të Investimeve ka pasur impakt dhe nëse ka bërë diferencën nga formate të ngjashme të dialogut publik – privat?*

- ✚ Rekomandimet e KI duhet të miratohen nga Qeveria;
- ✚ Pritshmëritë për KI ishin më të mëdha në fillim përse i përket të qenurit një platformë induktive për vendimet e qeverisë;
- ✚ Janë arritur disa rezultate por është ende herët për të bërë vlerësime;
- ✚ Më shumë angazhim nga anëtarët e qeverisë në KI sikurse edhe BERZH të llojë më shumë miratimin e rekomandimeve;
- ✚ KI solli modelin më të mirë të këtij dialogu në vend.

## Sugjerime për Përmirësim

*Cilat mund të jenë disa nga sugjerimet që mund të ofroni për përmirësimin e punës së Sekretariatit në lidhje me konsultimin, analizat e ofruara, natyrën e rekomandimeve, organizimin e mbledhjeve, votimin nga anëtarët, procesin e monitorimit të rekomandimeve, etj.?*

- ✚ Monitorimi i konsiderimit të rekomandimeve të KI;
- ✚ Kujdes me pjesën e monitorimit të rekomandimeve si dhe qëndrueshmërinë e anëtarëve të Këshillit duke ju referuar rolit që ka një anëtar i Këshillit me interes publik apo privat "Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë si një ndër institucionet më të rëndësishme në vend, në mbrojtje të interesave të sipërmarrjes private, duhet të ishte anëtare e përhershme e këtij Këshilli.

## Vizibiliteti

*Në lidhje me vizibilitetin e punës së Këshillit të Investimeve a mendoni se është i njohur sa duhet komuniteti i biznesit?*

- ✚ Puna e KI duhet të jetë më e dukshme veçanërisht në lidhje me rezultatet e miratuara nga Qeveria;
- ✚ Platforma e KI të përdoret më shumë nga Qeveria në lançimin e iniciativave me impakt për biznesin;

- ✚ Sekretariati të mbetet një njësi teknike;
- ✚ Ka ende hapësira për sipërmarrjen që të informohet lidhur me punën dhe rolin e Këshillit.

## Fushat për Fokusim

- ✚ Aftësitë e forcës punëtore
- ✚ Tërheqja e IHD-ve
- ✚ Sektori i energjisë
- ✚ Konkurrenca e padrejtë
- ✚ Sektorët që kanë lidhje me eksportet si psh modeli i call centers (BPO), prodhim, etj.
- ✚ Lejet
- ✚ Çështjet tatimore

## Qëndrueshmëria

*A e shikoni Këshillin e Investimeve si një platformë afatgjatë dhe me interes për biznesin? A mendoni se biznesi mund të kontribuojë iniciativa të tilla?*

- ✚ Platformë e nevojshme për vendin në terma afat-gjatë;
- ✚ Ndonëse një organ konsultativ, do të ndihmojë në strukturimin e debatit, opinionet dhe analizat;
- ✚ Për t' u konsideruar në të ardhmen, pagesa e një tarife anëtarësimi nga bizneset për vazhdimin e kësaj platforme.
- ✚ Numri i rekomandimeve të miratuara dhe masave të propozuara do të përcaktojë qëndrueshmërinë e iniciativës.

## Mbi Klimën e Investimeve

*Si e shikoni në vazhdim bashkëpunimin tuaj me Sekretariatit dhe Këshillin e Investimeve? A keni sugjerime për çështjet që duhet të trajtojnë në vijim Këshilli i Investimeve?*

- ✚ Zbatimi i reformës në drejtësi
- ✚ Kapacitetet dhe edukimi i administratës fiskale

- ✚ Edukimi i fermerëve për të bashkëpunuar së bashku
- ✚ Furnizimi me energji dhe investimet private në sektorin e energjisë
- ✚ Produkte investimesh për investitorët e mundshëm
- ✚ Mosplotësimi i nevojave të biznesit nga tregu i punës
- ✚ Zbatimi i legjislacionit për lejet e ndërtimit

KOMENTE NGA ANËTARË TË KI NGA KOMUNITETI I BIZNESIT, 2015-2016